



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË

Nr. 4133 Prot

Tiranë më 15/08 / 2024

NJOFTIM

**PËR SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, vendimin nr.643, datë 23.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurimit të hapur”, vendimit nr .4, datë 02/03/2022 të Këshillit të Gjykatës, si dhe shkresës nr.3198/1 prot., datë 14.06.2024 të KLGJ-së, Gjykata e Lartë, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

•1 (një) vend vakant, pozicioni - **“specialist i teknologjisë së informacionit “ - në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë, (kategoria ekzekutive IV-1).**

Pozicionet më sipër u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante ato janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Lëvizje paralele

29.08.2024

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Pranim në shërbimin civil gjyqësor

05.09.2024

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Siguron mbështetje për stafin e Gjykatës së Lartë duke analizuar dhe zgjidhur çështje të lidhura me rrjetin dhe sistemet informatike dhe të komunikimit;
- Mirëmban dhe përditëson infrastrukturën IT;
- Përcakton dhe implementon politikën, procedurat, dhe praktikën më të mira të IT;
- Kontribuon në planin për investime në fushën e IT;
- Krijon, mirëmban dhe përditëson faqen zyrtare online të Gjykatës së Lartë
- Mirëmban dhe përditëson databazën e Gjykatës së Lartë si dhe sistemet e njohurive bazë;
- Mirëmban dhe përditëson S/W dhe H/W të Gjykatës së Lartë përfshirë kompjuterat, laptop-ët, network-un, printimin, e-mailin dhe sistemet e lidhura në këtë fushë.

I.LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë **kushtet për lëvizjen paralele** si vijon:

- a - Të jenë nëpunës civilë gjyqësorë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- b - Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c - Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

Kandidatët duhet të plotësojnë **kërkesat e vecanta** si vijon:

- Të jetë diplomuar në fushën e Informatikës, Elektronikës, Inxhinieri Kompjuterike, ose Telekomunikacionit të paktën në nivelin ‘Master Shkencor’ ose të barazvlefshme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit arsimit të lartë;
- Të ketë të paktën 1 vite përvojë pune si specialist i teknologjisë së informacionit.
- Të kete certificate per pajisjet Cisco CCNA ose ekuivalent:
- Të kete certificate per Cybersecurity ose ekuivalent:
- Të kete certificate per HTML dhe CSS ose ekuivalent:
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Të ketë aftësi shumë të mira të komunikimit dhe organizimit të punës.

I.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **29.08.2024**, në ambjentet e Gjykatës së Lartë ose nëpërmjet postës, në adresën : *Gjykata e Lartë, Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë*, dokumentat e mëposhtëm:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurron.
- CV e përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave. (Bachelor dhe Master)
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Dokument të gjuhës së huaj.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Vërtetim banimi.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

I.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e lëvizjes paralele për kategorinë ekzekutive do të marrin informacion në faqen e Gjykatës së Lartë për fazat e mëtejshme sipas kësaj procedure të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraparak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë.

Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Kancelari i Gjykatës së Lartë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

I.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET KONKURRIMI

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”.

I.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

1. Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

2. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në udhëzimin nr. 85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë.

II.PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Gjykatës së Lartë dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor , që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore

Kandidatët duhet të plotësojnë **kërkesat e vecanta** si vijon:

- Të jetë diplomuar në fushën e Informatikës, Elektronikës, Inxhinieri Kompjuterike, ose Telekomunikacionit të paktën në nivelin ‘Master Shkencor’ ose të barazvlefshme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit arsimit të lartë;
- Të ketë të paktën 1 vite përvojë pune si specialist i teknologjisë së informacionit.
- Të kete certificate per pajisjet Cisco CCNA ose ekuivalent:
- Të kete certificate per Cybersecurity ose ekuivalent:
- Të kete certificate per HTML dhe CSS ose ekuivalent:
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

- Të ketë aftësi shumë të mira të komunikimit dhe organizimit të punës.

II.1 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda dates **05.09.2024** në ambjentet e Gjykatës së Lartë ose nëpërmjet postës, në adresën : *Gjykata e Lartë, Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë* dokumentat e mëposhtme :

- Kërkesë motivimi për aplikim për pozicionin vakant që konkurron.
- CV e përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave (Bachelor dhe Master)
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Dokument të gjuhës së huaj.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Vërtetim banimi.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Kancelari i Gjykatës së Lartë do të shpallë në faqen zyrtare të gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë :

- kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive,
- datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Kancelari , për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

II.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA E STRUKTURUAR ME GOJË

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;

b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;

c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në udhëzimin nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Gjykatës së Lartë, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive

- **për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,**
- **datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;**

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Gjykatës së Lartë duke filluar nga data **06.09.2024**.

Data e daljes së rezultateve do të jetë brenda datës **30.09.2024**. Pas arsyetimit dhe publikimit të vendimit për rezultatet e procedurës së emërimit nga Këshilli i Gjykatës së Lartë, ky vendim do t'u njoftohet të gjithë kandidatëve. Këshilli, pas marrjes së mendimit me shkrim nga kandidati fitues, shpall fituesin në faqen web të Gjykatës së Lartë www.gjykataelarte.gov.al dhe faqen zyrtare të KLGJ-së, www.klgj.al.

KËSHILLI I GJYKATËS GJYKATA E LARTË

Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë